



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality of Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje / Department of Education

Në bazë nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/ L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neni 84 dhe 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, neni 5, neni 14 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 të datë 28.04.2017, Drejtoria për Arsimit në Komunën e Rahovecit shpall:



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA GRAHOVAC
Drejtoria për Arsimit
Odeljenje za Obrazovanje

Nr. I prot. 531 Më 28.03.2025
Br. prot. RAHOVEC - GRAHOVAC

KONKURS

Për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025

1. Bursat ndahen për vitin akademik 2024/2025 për shkollimin universitar publik.
2. Numri i bursave të planifikuara është **150** (njëqind e pesëdhjetë) bursa;
3. Lartësia e bursës është **50 €** (pesëdhjetë euro) për muaj, për studentët me notë mesatare nën 9 (nëntë), për gjithsej **9 (nëntë) muaj**;
4. Lartësia e bursës është **60 €** (gjashtëdhjetë euro) për studentë që kanë notën mesatare **9 (nëntë)** e sipër, për gjithsej **9 (nëntë) muaj**.

Për ndarjen e bursave për nxënës të ShML-ve dhe të IAAP-së në komunën e Rahovecit, për vitin shkollor 2024/2025:

1. Bursat ndahen për vitin shkollor 2024/2025 për shkollimin e mesëm të lartë.
2. Numri i bursave të planifikuara është **35** (tridhjetë e pesë) bursa;
3. Lartësia e bursës është **25 €** (njëzet e pesë euro) për muaj, për gjithsej **9 (nëntë) muaj**.

Kriteret për ndarjen e bursave për studentë:

- Lëmia e studimit, përparësi kanë studentët e drejtimeve dhe profileve deficitare (matematikë, shkencë inxhinierike, fizikë, profile bujqësore etj);
- Suksesi gjatë studimeve (nota mesatare), përparësi kanë studentët me notë mesatare më të madhe;
- Gjendja ekonomike familjare, përparësi kanë studentët që kanë gjendje të dobët ekonomike në familjen e ngushtë (rastet sociale);
- Kategoritë e dala nga lufta, ku hyjnë fëmijët e familjeve të dëshmorëve.
- Nëse aplikojnë 2 studentë nga një familje e ngushtë (vëllezër/motra), njëri prej tyre mund të marrë bursë.

- Nëse aplikojnë 3 studentë nga një familje e ngushtë (vëllezër/motra), dy prej tyre mund të marrin bursë.

Kriteret për ndarjen e bursave për nxënës të SHML-ve dhe të IAAP:

- Të jetë nxënës i rregullt në SHML apo IAAP në komunën e Rahovecit;
- Të jetë nxënës i shkëlqyeshëm;
- Gjendja e dobët ekonomike familjare (rast social).
- Kategoritë e dala nga lufta, ku hyjnë fëmijët e familjeve të dëshmorëve.
- Nëse aplikojnë 2 nxënës nga një familje e ngushtë (vëllezër/motra), njëri prej tyre mund të marrë bursë, por duhet të jenë nxënës të shkëlqyeshëm;
- Nëse aplikojnë 3 nxënës nga një familje e ngushtë (vëllezër/motra), dy prej tyre marrin bursë, por duhet të jenë nxënës të shkëlqyeshëm.

Kohëzgjatja e akordimit (dhënies së bursës):

- Bursa akordohet me kohëzgjatje prej 1 (një) viti me të drejtë vazhdimi, nëse përlituesi i bursës ka regjistruar me sukses vitin pasues.

Dokumentet e nevojshme për aplikim të bursës për studentë:

- Kërkesa me biografi të shkurtër;
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet fusha e studimit dhe regjistrimi i vitit akademik 2024/2025;
- Certifikata e notave;
- Fotokopja e ID-kartelës;
- Dëshmi mbi gjendjen sociale (vetëm rastet sociale duhet ta kenë këtë dëshmi);
- Vërtetimi me të cilin vërtetohet përkatësia e familjes për kategoritë e dala nga lufta;
- Kopja e letënjoftimit;
- Certifikata e lindjes.

Dokumentet e nevojshme për aplikim të bursës për nxënës:

- Vërtetimi nga shkolla;
- Dëshmi për suksesin e nxënësit (certifikatë e notave);
- Certifikata e lindjes;

Për studentët: të drejtë aplikimi kanë vetëm studentët e regjistruar në nivelin bachelor në universitetet publike dhe ata duhet të jenë nga komuna e Rahovecit;

Për nxënësit: të drejtë aplikimi kanë vetëm nxënësit e regjistruar në shkollat e mesme të larta (SIIML) publike dhe në IAAP të komunës së Rahovecit.

Kohëzgjatja e konkursit:

- Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen;
- Dokumentet dorëzohen në zyrat e Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit;
- Afati i aplikimit fillon më 26 mars 2025 dhe zgjat deri më 25 prill 2025, në orën 16:00.

Rahovec,
25 mars, 2024



Avni Morina
Avni Morina
Drejtör